



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 116 prot.

Kamëz, më 27.07.2022

V E N D I M

Nr. 99 Datë 27/07-2022

MBI

**“MIRATIMIN E MANUALIT TË PROCEDURAVE PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN DHE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA, BULEVARDI I RI, SHKOZË” PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.87 Datë 26.07.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar me nr.7787 prot, datë 21.07.2022 dhe Bashkisë Kamëz me nr.6609 prot, datë 21.07.2022 “Për trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga zbatimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë” për Njësinë Administrative Paskuqan.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Manuali për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë” për Njësinë Administrative Paskuqan” paraqitet në ankesin bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI**

**Hysen KOLDASHI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ**

Nr. \_\_\_\_ prot.

Kamëz, më \_\_\_\_ .07.2022

**M A N U A L**

**I PROÇEDURAVE PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E  
TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK  
LEGALIZOHEN DHE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT  
“UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA, BULVARDI I RI,  
SHKOZË”  
PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN**

## TABELA PËRMLEDHËSE E MANUALIT

- Hyrje
- Përkufizime
- Kuadri Ligjor
- Struktura e ngarkuar për zbatimin e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen për njësinë administrative paskuqan në zbatim të vkm nr.409, datë 16.06.2022 “ Për rregullat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”

*Grupi i Punës*

*Kryetari i Bashkisë ose Personi i Autorizuar prej tij*

*Këshilli Bashkiak*

- Subjektet Jopërfitues
- Mënyrat e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen
- Fazat e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen

## HYRJE

---

Ky manual do të shërbejë si udhëzues për vënien në zbatim të bazës ligjore për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit nga Bashkia Kamëz si organ përgjegjës, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen, të prekur nga zbatimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë” për Njësinë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz.

Qëllimi i manualit është zbatimi dhe unifikimi i rregullave si dhe procedurave të cilat duhet të ndjek Grupi i Punës i ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, sipas Urdhërit me nr.571 prot. Datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë”

Gjithashtu manuali përcakton qartë rolin dhe përgjegjësitë e Bashkisë Kamëz, ku sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Autoritetin Rrugor Shqiptar me nr.7787 prot. datë 21.07.2022, protokolluar me tonin me nr.6609 prot. Datë 21.07.2022, Bashkia Kamëz në cilësinë e organit përgjegjës, merr përsipër:

- a) Të ndjekë të gjitha procedurat ligjore me qëllim miratimin dhe realizimin e trajtimit të përfituesve të cilët janë njoftuar për përjashtim dhe legalizim i ndërtimit pa leje;
- b) Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e marrëveshjes për përfitimin nga trajtimi (MPT) me përfituesit, si dhe të trajtojë këto të fundit përmes fondit të banesave dhe trajtimit financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3 (tre) vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes;
- c) Në cilësinë e organit përgjegjës, me miratimin e projektit dhe vënien në dispozicion nga ARRSH, t'i kërkojë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës informacionin/ dokumentacionin për secilin prej subjekteve që do të trajtohen;

Së fundmi, ky manual përcakton një kuadër rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efikasitet të veprimtarisë së grupit të punës së ngritur sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, i cili do të jetë përgjegjës për trajtimin e subjekteve përfitues, në zbatim të VKM nr.409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”.

## **PËRKUFIZIME:**

*Në këtë manual termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:*

1. **“Ligji”** - Ligji nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
2. **“VKM”** - Vendimi nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”;
3. **“Marrveshje Bashkëpunimi”** - Marrveshje bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Bashkisë Kamëz “Për trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga zbatimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë”;
4. **“Përfitues”** - Subjekti i cili është njoftuar për përjashtim nga legalizimi i ndërtimit pa leje nga organi administrativ kompetent (Drejtoria Vendore e ASHK-së), që plotëson kushtet e përfitimit përmes fondit të banesave dhe trajtimit financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3 (tre) vjeçar nga momenti i firmosjes së marrveshjes (MPT) sipas kritereve të parashikuara nga VKM nr.409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”;
5. **“MPT”** - Marrëveshja për përfitimin e trajtimit është marrëveshja që lidhet midis organit përgjegjës, “Njësia Administrative Paskuqan” me përfaqësues Administratorin dhe Përfituesit, me qëllim përfitimin nga subjekti përfitues të formave të parashikuara nga VKM nr.409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen” për trajtimin e përfituesve;
6. **“Certifikatë familjare”**- Përbërja familjare në momentin e njoftimit nga Njësia administrative Paskuqan, mbi fillimin e procedurave administrative për trajtimin e subjekteve që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë”;
7. **“Vërtetim fakti”** - Vërtetim për faktin e të dhënave për banorët e territorit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia ose nga vetë banorët sipas parashikimeve të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
8. **“Grupi i Punës”** - Është grupi i punës i ngritur me Urdhërin me nr.571 prot, datë 15.07.2022 nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen për Njësinë Administrative Paskuqan, në zbatim të VKM nr.409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen” për trajtimin e përfituesve.

## KUADRI LIGJOR

---

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”;

Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

VKM nr.409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”;

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar me nr.7787 prot, datë 21.07.2022 dhe Bashkisë Kamëz me nr.6609 prot, datë 21.07.2022 “Për trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga zbatimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë”;

Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”

**Struktura e ngarkuar për zbatimin e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen për njësinë administrative paskuqan në zbatim të vkm nr.409, datë 16.06.2022  
“Për rregullat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”**

Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiptonja - Bulevardi i Ri, Shkozë” për Njësinë Administrative Paskuqan, grupi i punës përgjegjës do të jetë si më poshtë:

- |                    |   |
|--------------------|---|
| - Uarda Elezi      | Zv. Kryetare                                    |
| - Teuta Cami       | Dr. Emergjencave Civile dhe Strehimit           |
| - Eduart Bodini    | Administrator i Njësisë Administrative Paskuqan |
| - Raimonda Nikolli | Dr. Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale     |
| - Fatjon Kordhaku  | Ing. Njësia Administrative Paskuqan             |
| - Mevlud Shehu     | Jurist pranë Njësisë Administrative Paskuqan    |
| - Xhevahir Zenelaj | Ing. Pranë Dr. Urabnistikës                     |
| - Mirela Ndreu     | Sp. Pranë Drejtorisë së Financës                |
| - Nderim Pasha     | Ing. Pranë Dr. Investimeve                      |

Grupi i punës i legjitimuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me qëllim trajtimin e subjekteve që janë njoftuar për përjashtim nga legalizimi i ndërtimit pa leje, kanë përgjegjësinë për të trajtuar:

1. Përmes fondit të banesave, në zbatim të marrëveshjes MPT që lidhet midis Bashkisë Kamëz dhe përfituesit;
2. Trajtimin financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3 (tre) vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes dhe lëshimit të godinës;

Grupi i punës do të kujdeset për njoftimin e subjekteve të përjashtuara nga legalizimi i ndërtimit pa leje, mbi fillimin e procedurave administrative përkatëse nga Bashkia Kamëz si organi përgjegjës për të ndjekur të gjitha procedurat me qëllim miratimin dhe realizimin e trajtimit të subjekteve përfitues që do të trajtohen përmes bonusit të qirasë dhe fondit të banesave sipas përcaktimeve të MPT.

Grupi i punës administron informacionin/ dokumentacion e nevojshëm të subjekteve përfitues dhe jo përfitues që janë njoftuar për përjashtim nga legalizimi i ndërtimit pa leje dhe që preken nga realizimi i projektit.

Grupi i punës harton Raportin Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë, në të cilën detajohen procedurat e ndjekura dhe listën e subjekteve përfituese, e cila i paraqitet për miratim Këshillit Bashkiak.



## ADMINISTRATORI I NJËSISË ADMINISTRATIVE PASKUQAN

---

*Administratori realizon funksionet e mëposhtme:*

- Trajton kërkesë-ankesat e mundshme të subjekteve të ndryshëm që nuk janë shpallur përfitues;
- Lidh marrveshjen për përfitimin e trajtimit me përfituesit, me qëllim përfitimin nga ky i fundit të formave të përfitimit të parashikuara nga VKM ;

## KËSHILLI BASHKIAK

---

- Miraton listën përfundimtare të përfituesve ku përcaktohen qartë format e trajtimit të subjekteve;
- Miraton vlerës të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që preken nga projekti “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë” Njësia Administrative Paskuqan;

## SUBJEKTET JOPËRFITUES

---

- I. **Nuk është përfitues poseduesi, ndërtimi pa leje i cili gjendet në një nga kushtet e mëposhtme:**

Nuk ka cilësitë që e klasifikojnë si ndërtim pa leje:

*\*Shënim:* “Ndërtim pa leje” është ndërtimi i lidhur në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose me ndërtesa të tjera, i cili është bërë pas datës 10.08.1991 dhe paraqitet në një nga këto lloje:

- Objekti, apo shtesa në ndërtim të regjistruar, pavarësisht funksionit të tij, është kryer në një mungesë të një leje ndërtimi;
- Objekti në shkelje të lejes së ndërtimit, si objekt i paregjistruar që ka shtesa në tejkalim të lejes së ndërtimit apo ndryshim të funksionit të hapësirave, në raport me këtë leje;
- Poseduesi i ndërtimit pa leje me vullnetin e tij, ka hequr dorë nga e drejta për të përfituar legalizim sipas të dhënave që administron Drejtoria Vendore e ASHK-së;

- Ndërtimet pa leje që janë ndërtuar pas hyrjes në fuqi të ligjit, që ASHK konstaton në ortofotin e realizuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nga autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapsinor;
- Objekti pa leje, sipërfaqia e bazës së të cilëve shtrihet plotësisht mbi tokën private të të tretëve, ku dokumentet e planifikimit të territorit parashikojnë ndërtime mbi 6 (gjashtë) kate nga niveli zero;
- Nuk përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 69, pika 9;
- Është përjashtuar nga legalizimi përpara hyrjes në fuqi të ligjit dhe akti administrativ i përjashtimit mbetet në fuqi;
- Për ndërtimin është deklaruar përfundimi i procedurës administrative pa vendim përfundimtar, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave që përcakton rregullat e evidentimit të ndërtimeve pa leje;

*\*Shënim:* Ndërtimet pa leje të cilat preken nga realizimi i projektit dhe ndodhen në një nga kushtet e mësipërme duhet të referohen nga vetë institucioni i ASHK-së. Në çdo rast kur grupi i punës konstaton një nga kushtet e mësipërme, i drejtohet për informacion Drejtorisë Vendore të ASHK-së.

**Nuk është përfitues subjekti i cili ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:**

- a) Subjekti i cili ka në pronësi ose posedim të ligjshëm më shumë se një banesë, brenda juridiksionit territorial të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b) Anëtarët e familjes së subjektit të përjashtuar nga legalizimi i ndërtimit pa leje, kanë në pronësi ose posedim të ligjshëm më shumë se një banesë brenda juridiksionit territorial të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- c) Subjekti i cili nuk është referuar nga Drejtoria Vendore e ASHK-së si subjekt i përjashtuar nga legalizimi i ndërtimit pa leje;
- d) Subjekti i cili nuk është banor pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku do të realizohet projekti;

## MËNYRAT E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN

Përfituesi, të cilit i është njoftuar përjashtimi nga legalizimi i ndërtimit pa leje, trajtohet me një nga format e shpërblimit ose të trajtimit të veçantë të parashikuar nga VKM, si më poshtë vijon:

- a) Trajtim përmes fondit të banesave, në zbatim të marrëveshjes MPT, që lidhet midis organit përgjegjës dhe përfituesit;

*Fondi i Banesave që do të vendoset në dispozicion për trajtimin e përfituesve, do të jetë nga tërësia e banesave në pronësi të Bashkisë Kamëz të përfituara sipas ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", apo forma të tjera të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi. Për banesat në pronësi të Bashkisë Kamëz, kalimi i tyre në favor të subjektit përfitues do të bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore.*

<i>Përbërja familjare në momentin e njoftimit</i>	<i>Sipërfaqja në metër katrorë (m<sup>2</sup>)</i>
<b>Deri në 4 anëtar</b>	60 m <sup>2</sup> deri në 70 m <sup>2</sup>
<b>Nga 5 anëtar deri në 7 anëtar</b>	70 m <sup>2</sup> deri në 90 m <sup>2</sup>
<b>Më shumë se 7 anëtar</b>	Mbi masën prej 90 m <sup>2</sup> , do të shtohen 10 m <sup>2</sup> për çdo anëtar më shumë

- b) Trajtimin financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3- vjeçar nga momenti i firmosjes së MPT dhe lëshimit të godinës;

*Përfituesit që nuk zotërojnë asnjë banesë tjetër të ligjshme apo pa leje brenda territorit të Bashkisë Kamëz, të ligjshme apo pa leje, por të legalizueshme, përveç ndërtimit të përjashtuar nga legalizimi, përfitojnë edhe trajtim financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3- vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes dhe lëshimit të godinës. Niveli i qirasë mesatare në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz miratohet nga Këshilli Bashkiak Kamëz.*

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr. frymësh	Sasia	Çmimi mesatar(lekë pa TVSH)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsionerë)	Muaj	1-2	1	15,000
2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	3-4	1	21,000
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	5	1	25,000
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	6-8	1	27,000

**Shënim:** Vlerat e mësipërme të subvencionimit të qirasë janë propozuar pranë Këshillit Bashkiak Kamëz, nga Drejtoria e Emergjencave Civil dhe Strehimit në Projekt-Vendimin nr.80, datë 19.07.2022 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që preken nga projekti Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë”.

## **FAZAT E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN**

### **Faza e parë:**

Grupi i punës i cili është përgjegjës për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore me qëllim miratimin dhe realizimin e trajtimit të përfituesve që preken nga realizimi i projektit, paraprakisht duhet ti kërkojë Drejtorisë Vendore të ASHK-së informacionin/ dokumentacionin për secilin prej subjekteve që do të trajtohen, si më poshtë:

- 1- Kopje të vendimit të legalizimit;
- 2- Dokumentacionin hartografik (genpaln dhe planimetri);
- 3- Ekstraktin nga baza e të dhënave për ndërtimin që nuk legalizohet;
- 4- Informacionin kadastral;
- 5- Të dhëna nëse përfituese apo anëtarët e tjerë të familjes zotërojnë ose jo banesë tjetër të ligjshme brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Kamëz;

Për çdo subjekt të referuar nga institucioni i ASHK-së duhet krijuar një dosje e veçantë ku të administrohet dokumentacioni i referuar si më sipër.

Grupi i punës duhet të mbajë një libër protokolli pranë Njesisë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz ku të evidentohen të dhënat e subjekteve që referohen nga Drejtoria Vendore e ASHK-së.

Për çdo subjekt në dosjet përkatëse duhet të mbahet procesvebali i të gjithë dokumentacionit që administrohet nga grupi i punës.

Për çdo subjekt përfitues duhet administruar në dosje Vetdeklarimi tip (bashkangjitur këtij manuali) mbi disponimin që gëzon për një të drejtë reale (pronësi/ bashkëpronësi ose posedimi të ligjshëm) mbi pasuri të paluajtshme me funksion banimi, në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kamëz.

## **LISTA E DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË KETË ÇDO DOSJE E SUBJEKTIT PËRFITUES**

---

- Vendimi që përjashtohet nga procesi i legalizimit;
- Certifikata e përbërjes familjare (referim data e njoftimit nga Njësia Administrative Paskuqan);
- Gen-Plan dhe Planimetri e objektit të përjashtuar nga procesi i legalizimit;
- Informacioni kadastral i objektit që nuk legalizohet;
- Ekstrakti nga baza e të dhënave nga ndërtimet që nuk legalizohen;
- Vërtetim fakti (dokument i lëshuar nga Kryetari i Fshatit i cili provon se aplikuesi ka bashkëjetuar me anëtarët e familjes);
- Dëshmia e çeljes së trshëgimisë në rast se aplikuesi përfitues ka ndërruar jetë;
- Vetdeklarimin mbi numrin e pasurive të paluajtshme strukturë banimi brenda teritorit të njësisë të vetëqeverisjes vendore.

## NJOFTIMI - FAZA E DYTË

---

Menjëherë pas administrimit të informacionit/ dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Vendore e ASHK-së, grupi i punës fillon procedurën e akordimit të trajtimit dhe kryen veprimet, si më poshtë vijon:

1. Njofton mbajtësin e statusit të përfituesit për fillimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjes MPT, ku i bën me dije formën e trajtimit dhe procedurën e realizimit të saj, sipas parashikimeve të VKM.

*\*Shënim:* Njoftimi i subjekteve përfitues duhet realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar (shkresë zyrtare) dhe në kushtet kur subjekti që mban statusin e përfituesit nuk merr dijëni apo refuzon të marrë njoftimin në këto raste njoftimi bëhet me shpallje në këndin e njoftimeve publike konform parashikimeve ligjore në fuqi për njoftimet me shpallje publike. Për çdo subjekt përfitues hartohet njoftimi i përfitimit sipas SHTOJCËS C. Shkresat zyrtare të njoftimit të përfitimit duhet të protokollohen pranë Njesisë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz.

2. Subjekti përfitues duhet të depozitojë pranë Njesisë Administrative Paskuqan, certifikatën familjare të datës së njoftimit për fillimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjes së MPT.

*\*Shënim:* Familjet të cilat sipas certifikatës familjare kanë në përbërjet e tyre më shumë se një "Kurorë", çdo kurorë do të përfitojë si subjekt më vete. Fakti i mësipërm do të vërtetohet me vërtetim fakti, sipas të dhënave që ka në dijëni Kryetari i Fshatit. (Shtojca B)

3. Grupi i punës harton paraprakisht një kontratë model "Marrëveshje për përfitimin e Trajtimit" e cila duhet të parashikojë format e shpërblimit ose trajtimit të veçantë sipas VKM.

*\*Shënim:* Modeli i marrëveshjes për përfitim trajtimi, miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak konform parashikimeve të legjislacionit në fuqi mbi trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen.

4. Pas administrimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në dosjet e subjekteve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen, grupi i punës shqyrton dhe vlerëson përzgjedhjen e subjekteve që përfitojnë konform parashikimeve ligjore të VKM.
5. Procesi i përzgjedhjes së përfituesve finalizohet me zbardhjen e porces-verbalit përkatës pjesë e të cilit është edhe lista përfundimtare e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen. Grupi i punës, paraqet procesvebalin e mbledhjes së bashku me listën përfundimtare të përfituesve. Njëkohësisht, Grupi i Punës harton Raportin Përmbledhës i cili i përcillet Kryetarit të Bashkisë dhe e informon në lidhje me listën e subjekteve që përfitojnë nga VKM.

## LIDHJA E MARRËVESHJES - FAZA E TRETË

---

Pas miratimit të listës së subjekteve përfitues nga Këshilli Bashkiak Kamëz, Administratori i Njësisë Paskuqan, prej tij lidh marrëveshjen për përfitimin e trajtimit MPT sipas modelit TIP të miratuar paraprakisht nga Këshilli Bashkiak. Lidhja e MPT ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe përfituesit duhet të mbyllet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për përfitimin.

1. Në kuadër të detyrimeve të marra përsipër nga Bashkia Kamëz sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar me nr.7787 prot, datë 21.07.2022 dhe Bashkisë Kamëz me nr.6609 prot, datë 21.07.2022, grupi i punës duhet të njoftojë në kohë dhe pa vonesë ARRSH-në lidhur me marrëveshjet që janë lidhur dhe rastet kur përfituesit refuzojnë të lidhin këtë të fundit, pasi janë respektuar të gjitha afatet e njoftimit sipas parashikimeve ligjore në fuqi;

*Me lidhjen e marrëveshjes MPT, përfituesi brenda 20-ditëve përfiton pagesën e qirasë, për një afat tre vjeçar.*

2. Moslidhja e marrëveshjes së MPT nga ana e përfituesit brenda afatit 30-ditor nga njoftimi i kryer nga organi përgjegjës nuk pezullon zbatimin e projektit;
3. Në rastet kur përfituesi, pas 6 (gjashtë) muajsh nga marrja e njoftimit për lidhjen e marrëveshjes, nuk pranon asnjë nga format e trajtimit social-ekonomik, apo refuzon trajtimin, subjekti përfitues do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij dhe do të konsiderohet si i trajtuar nga organi përgjegjës;

(SHTOJCA A)

**VETËDEKLARIM MBI PASURITË E PALUAJTSHME**

Unë i nënshkruari ....., me numër indentifikimi personal sipas letërnjoftimit....., i lindur më ....., deklaroj me vullnet të lirë nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se përveç pronës së deklaruar në këtë aplikim, unë ose antarët e familjes time sipas certifikatës familjare:

- Nuk kam/ nuk kemi
- Kam/ Kemi

Të drejta pronësie/ bashkëpronësie apo posedimi të ligjshëm mbi pasuri të tjera të paluajtshme me funksion banimi, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku do të zhvillohet projekti Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, të cilat me një prej mënyrave si më poshtë:

<input type="checkbox"/> Certifikatë Pronësie	<input type="checkbox"/> Listë Trojesh	<input type="checkbox"/> Kontratë Pronësie/Sipërmarrje	<input type="checkbox"/> Vërtetim Karabinaje
<input type="checkbox"/> Vërtetim Hipotekor	<input type="checkbox"/> Leje Legalizimi	<input type="checkbox"/> Leje Ndërtimi	<input type="checkbox"/> Kontratë Shkëmbimi
<input type="checkbox"/> Kartelë e Pasurisë	<input type="checkbox"/> Leje Ndërtimi	<input type="checkbox"/> Vërtetim Fakti(94')	<input type="checkbox"/> Akt-MArrëveshje
<input type="checkbox"/> Vërtetim Legalizimi	<input type="checkbox"/> Kontratë Privatizimi	<input type="checkbox"/> Vërtetimi i Komisionit për Kthim dhe Kompesim	<input type="checkbox"/> Të Tjera(Specifiko)
<input type="checkbox"/> Aplikim sipas VKM 442	<input type="checkbox"/> Kontratë Shitje	<input type="checkbox"/> Vendim Gjysorë	

Të sqarohen informacionet shtesë mbi pasuritë e paluajtshme të fituara me një prej mënyrave të më sipërme ,(lloji/adresa/bashkëpronarët nëse ka):

-----  
-----

- I gjithë informacioni i deklaruar në këtë deklaratë është i vërtetë dhe jam në dijeni se për çdo informacion të rremë, mua ose anëtarve të familjes time iu hiqet e drejta për të përfituar nga trajtim sipas VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, si dhe ne rast përfitimi të padrejtë përfituesi detyrohet të kthejë çdo formë trajtimi .



- Jamë i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i kësaj deklarate mund të përcjellë fillimin e procedurave për përgjegjësinë civile dhe penale sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- Pranojë që, në rast së përzgjidhem për tu trajtuar sipas VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, të bëhet verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore.

**Deklaruesi -Emër Mbiemër**

\_\_\_\_\_

**Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Në prezencë të:**

\_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ .2022

(SHTOJCA B)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN

Nr. \_\_\_\_ prot.

Kamëz, më \_\_\_\_ .07.2022

**VËRTETIM FAKTI**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ neni 71 pika 4

Me anë të të cilit vërtetohet se z. \_\_\_\_\_, me nr. ID \_\_\_\_\_, i lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, është banor i Njesisë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz me adresë vendbanimi Rruga “\_\_\_\_\_” Nd. \_\_. Familja e Z. \_\_\_\_\_, përbëhet nga dy kurorë, përkatësisht:

- 1- Kurora 1:
- 2- Kurora 2:

E lëshohet këtë vërtetim me kërkesë të të interesuarit për konfirmim të dhënash.

KRYETARI I FSHATIT

\_\_\_\_\_

**ADMINISTRATOR**

**Eduart BODINI**

\_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN

(SHTOJCA C)

Nr \_\_\_\_\_ Prot .

Paskuqan , më \_\_ / \_\_ 2022

**Lënda:** Njoftim

**Znj./ Z.** \_\_\_\_\_

**Adresa: Rruga** \_\_\_\_\_

**Tel:** +355 \_\_\_\_\_

*I/E nderuar z./ znj.* \_\_\_\_\_

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”; VKM nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Vendimi nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, “Për përjashtimin nga legalizimi i ndërtimit pa leje”;

Në bazë të skualifikimit të ardhur nga ASHK Kamëz-Vorë, për objektet të cilat preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiptonja – Bulevardi i Ri, Shkozë” si dhe në zbatim të vendimit të sipërcituar:

Ju bëjmë me dije se në zbatim të pikës 1 dhe 10, të kreut II, si dhe tabelës nr.1 bashkangjitur të vendimit nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen” ju jeni përfitues i trajtimit të veçantë të parashikuara në këtë vendim.

Përsa më sipër, ju duhet të paraqiteni pranë Bashkisë Kamëz, për lidhjen e marrëveshjes së përfitimit dhe trajtimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

*Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,*

**ADMINISTRATOR**  
**Eduart BODINI**

(SHTOJCA D)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_.07.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET

Z./ Znj. \_\_\_\_\_

DHE  
BASHKISË KAMËZ

“PËR  
ZBATIMIN E PROJEKTIT  
UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA – BULEVARDI RI, SHKOZË”

Sot më datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_2022, nënshkruhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve të mëposhtme:

**Bashkia Kamëz** në adresën: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 492 Kamëz, përfaqësuar për qëllim të kësaj marrëveshje nga **Z. Eduart Bodini** i quajtur këtu e më poshtë **Njësia**, referuar si “Palët” dhe në mënyrë individuale si “Pala”

*Dhe*

Z./ Znj. \_\_\_\_\_ me nr ID. \_\_\_\_\_ banues ne  
adresën: Rruga “\_\_\_\_\_”

**Kushtet Paraprake:**

Bashkia Kamëz në kuadër të implementimit të projektit **Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri, Shkozë** merr përsipër të bashkëpunoj në të gjithë hapat e nevojshme për zbatimin e projektit dhe marrjen e të gjitha masave paraprake për mbarëvajtjen dhe parapërgatitjen e kushteve duke garantuar të drejtat e personave, prona e të cilëve preket nga projekti konkret.

## **Baza Ligjore**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”; VKM nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Vendimi nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, “Për përjashtimin nga legalizimi i ndërtimit pa leje

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi si më poshtë:

### **Neni 1**

#### **Objekti i marrëveshjes dhe shtrirja e bashkëpunimit**

Palët në këtë marrëveshje angazhohen në lidhje me:

1. Përcaktimin e detyrave specifike të secilit prej tyre, në kuadër të realizimit dhe zbatimit të procedurës së trajtimit, në kuptim të këtij vendimi;
2. Parashikimin e trajtimit përmes fondit të banesave në kuptim të pikës1/a, të kreut II, të vendimit nr.409, datë 16.6.2022 të Këshillit të Ministrave;
3. Parashikimin e fondit të nevojshëm financiar me qëllim kryerjen e pagesave të qirasë që akordohen në favor të përfituesve, në kuptim të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 409, datë 15.6.2022 të Këshillit të Ministrave;

### **Neni 2**

#### **Përcaktimi i formave të përfitimit**

1. Bashkia Kamëz do të përgjigjet për kompensimin e personave që do të trajtohen përmes fondit të banesave, sipas parashikimeve të tabelës 1 të VKM nr.409, datë 15.6.2022 të Këshillit të Ministrave.
2. Personat që preken nga projekti dhe që nuk zotërojnë asnjë banesë tjetër të ligjshme apo pa leje brenda territorit të Bashkisë Kamëz, por të legalizueshme, përveç ndërtimit të përjashtuar nga legalizimi, përfitojnë edhe trajtim financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes dhe lëshimit të godinës.
3. Mbulimi i shpenzimeve për pagesën e qirasë do të bëhet sipas parashikimeve të pikës 2, shkronja “a” “b” dhe “c” të vendimit nr. 409, datë 15.6.2022 të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 3**

#### **Afati i marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një afat 3 (tre) vjeçar.
2. Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes është data në të cilën nënshkruhet kjo marrëveshje dhe bëhet lëshimi godinës sipas pikës 2 kreu II vendimit nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen” prej nga fillojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 4**  
**Vlera e subvencionimit qirasë**

1. Palët janë të detyruar të zbatojnë nivelin e qirasë për frymë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022 “**Për miratimin e vlerës të subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja Bulevardi i ri, Shkozë Njësia Administrative Paskuqan**”.

**Neni 5**  
**Personat e kontaktit**

1. Palët caktojnë personat e kontaktit, të cilëve u drejtohen komunikimet verbale apo të shkruara, komunikimet elektronike, si dhe përfaqësojnë palët në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kësaj marrëveshje.
2. Personat e kontaktit janë si më poshtë vijnë:
  - Z./ Znj. \_\_\_\_\_ me adresë e-mail: \_\_\_\_\_; me nr. Tel: +355 \_\_\_\_\_
  - **Bashkia Kamëz** emëron përfaqësues të tij Z./ Znj. \_\_\_\_\_, me adresë e-mail: \_\_\_\_\_ me nr. Tel: + 355 6 \_\_\_\_\_.
3. Palët marrin përsipër që nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të bashkëpunojnë e të konsultohen.
4. Çdo njoftim i dhënë nga njëra palë tjetrës për zbatimin e kësaj marrëveshje, si dhe çdo komunikim midis palëve mund të bëhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet e-mailit, telefonisë ose në rrugë shkresore.

**Neni 6**  
**Njoftimi i subjekteve**

1. Bashkia Kamëz përgatit shkresat përcjellëse dhe administron korrespondencën me personat që do të përfitojnë sipas VKM-së së cituar në pikën 1 të këtij neni.
2. Bashkia Kamëz në shkresën drejtuar secilit posedues i njofton formën e trajtimit të parashikuara në shkronja “a” të pikës 1 të kreut II të VKM-së nr. 406, datë 15.6.2022 dhe i jep një afat 30 ditor për të kthyer përgjigje si dhe formën e përgjigjes.

**Neni 7**  
**Miratimi i MTP**

Bashkia Kamëz kryhen procedurat me qëllim miratimin dhe realizimin e trajtimit të përfituesve sipas pikës 1, shkronja "a", dhe 2, të kreut II të VKM-së nr. 409, datë 15.6.2022.

**Neni 8**  
**Zgjidhja e marrëveshjes**

Palët kanë të drejtë, që me marrëveshje me shkrim midis tyre, të zgjidhin marrëveshjen, nëpërmjet njoftimit të ndërsjellë me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para.

**Neni 9**  
**Dispozitat e fundit**

1. Çdo rregullim tjetër, i cili nuk është parashikuar në këtë marrëveshje do të zbatohet sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Çdo ndryshim në dispozitat e kësaj marrëveshje do të bëhet me marrëveshje me shkrim të palëve.
3. Në rast mosmarrëveshjesh, kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim, të dy palët mund t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Marrëveshja me kushtet e saj do të interpretohet si një e tërë. Në rast se ndonjë kusht, ose frazë krijon paqartësi, ajo duhet të interpretohet në kontekstin e tërë kontratës dhe sipas qëllimit që kanë pasur të dyja palët.
5. Bisedimet, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në lidhje me çdo konflikt që mund të lindë gjatë dhe pas zbatimit të kontratës, mbështeten në frymën e bashkëpunimit.
6. Kjo marrëveshje është hartuar në 6 (gjashtë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, secila me të njëjtën vlerë ligjore, përkatësisht nga 3 (tre) kopje për secilën palë.
7. Palët pasi e lexuan e gjetën në përputhje me ligjin dhe interesave të tyre e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të plotë.

**SUBJEKTI PËRFITUES**

Z./ Znj. \_\_\_\_\_

**PERSONI I AUTORIZUAR**

**ADMINISTRATOR**

**Eduart BODINI**

Datë, më ...../ ...../ 2022

## GRUPI I PUNËS

- Uarda Elezi
  - Teuta Cami
  - Eduart Bodini
  - Raimonda Nikolli
  - Fatjon Kordhaku
  - Mevlud Shehu
  - Xhevahir Zenelaj
  - Mirela Ndreu
  - Nderim Pasha
- Zv. Kryetare  
Dr. Emergjencave Civile dhe Strehimit  
Administrator i Njesisë Administrative Paskuqan  
Dr. Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale  
Ing. Njësia Administrative Paskuqan  
Jurist pranë Njesisë Administrative Paskuqan  
Ing. Pranë Dr. Urabnistikës  
Sp. Pranë Drejtorisë së Financës  
Ing. Pranë Dr. Investimeve